



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 21.07.2021 morri,

VENDIM

Aplikimi me numër 12-4772/1 i paraqitur nga ///, Komuna ///, **REFUZOHE**T.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, sipas pohimeve të theksuara në denoncim ka vepruar, për të cilën është marrë vendim me numër 12-425 / 3 të datës 21.06. 2021 e cila është publikuar në ueb-faqen e internetit të KSHPK -së.

Lënda me numër 12 -4772/1 të datës 10.10.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4772/1 e datës 10.10.2019 u formua në bazë të denoncimit, të dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga ///, Komuna /// me datë 08.10.2019, përmes një shkrese nga Komuna /// në të cilën shtojcë janë dorëzuar edhe shkresat dorëzuar deri te Komuna nga ///.

Në denoncim janë nxjerr pohime për gjurmim të rërës dhe zhavorrit nga shtrati i lumit /// në zonën e fshatit /// me të cilin ndrihet rrjedha e ujit të lumit dhe priten pemët, me të cilin rritet rrethimi nga erozioni i tokës dhe prish mjedisin ekzistues eko- sistem, paraqet rrezik të ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm, dhe rrezik nga shkatërrimi i sipërfaqes së madhe të tokës së punueshme përgjatë ///, nga fshati /// në fshat ///. Kërkesat e parashtruesve janë në drejtim të heqjes së lejeve, në mënyrë që të ndalojnë gjurmimin e rërës, dhe përfundimin e prerjes dhe shkatërrimit të rripave të mbrojtur. Në denoncim thuhet gjithashtu se parashtruesit gjatë vitit 2019 paraqitën më shumë prashtrësia në Komunë ///, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Qeveri, Inspektoratin Shtetëror për Mjedisin dhe Këshillin e Inspektimit.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit përcaktoi se tashmë ka veprim sipas pretendimeve nga denoncimi i treguar në lëndën me numër 12-425 / 1 të datës 26.01.2021, për të cilin në seancën e 49-të të KSHPK-së, të mbajtur më 07.06.2021, është miratuar vendim për ndalimin e veprimit mbi pohimet nga lëndapër

shkak të tejkalimit të situatës, gjegjësisht heqjes së koncesionit për gërmimin e rërës në lokacionin e caktuar, dhe pas veprimit kompetent të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit. Vendimi Nr. 12-425 / 3 i datës 21.06.2021 është publikuar në ub- faqen e internetit të KSHPK-së.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së

Punuar nga: A.R.M.

Miraturar nga: K.N, anëtar i KSHPK - së

**KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

